



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIM

A.nr. 410/2017
Arsim Biçaku

Lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3451/2015

Për: Z. Hasan Shala, Kryetar
Gjykata e Apelit

Prishtinë, më 29 maj 2018

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.3451/2015, sipas Aktgjykimit C.Nr.899/2012, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Arsim Biqaku, (në tekstin e mëtejme *ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe në shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për lëndën AC.nr. 3451/2015, që ka të bëjë me kthimin në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Baza ligjore

3. Sipas nenit 135, para. 3 të Kushtetutës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”.
4. Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: “*Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave*”.

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbledhen si në vijim:

5. Më 9 dhjetor 2003, *ankuesi* ka parashtruar padi për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale për periudhën e largimit nga puna.
6. Më 1 korrik 2004, Gjykata Komunale në Prizren ka nxjerr Aktgjykim C.nr.769/03, të datës 1 korrik 2004, i cili është në favor të *ankuesit*.
7. E paditura kundër Aktgjykimit C.nr.769/2003 të datës 1 korrik 2004, të Gjykatës Komunale në Prizren, ushtron ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e cila me Aktvendim Ac.nr.361/2004, të datës 9 dhjetor 2004, e hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme dhe e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.769/2003, të datës 1 korrik 2004.
8. Më 24 mars 2005, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon revizionin e të paditurës, me aktvendim Rev.nr.51/2005, të datës 24 mars 2005, e prish aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.361/2004, të datës 9 dhjetor 2004 dhe lëndën e kthen në rivendosje.
9. Më 10 gusht 2005, Gjykata e Qarkut në Prizren e prish Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.769/03, të datës 1 korrik 2004 dhe lënda i kthehet Gjykatës së Shkallës së parë në vendosje të sërishme.
10. Më 26 tetor 2006, për të dytën herë Gjykata Komunale në Prizren vendos me Aktgjykim C.nr.681/2005, në favor të *ankuesit*.

11. Më 19 janar 2007, Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktgjykim Ac.nr.523/2006, të datës 19 janar 2007, refuzon si të pa bazë ankesën e të paditurës dhe për të dytën herë e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.681/05, të datës 26 tetor 2006.
12. Më 28 shkurt 2007, e paditura ushtron revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.523/2006, të datës 19 janar 2007, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
13. Më 31 mars 2007, *ankuesi* ushtron kundër përgjigje ndaj të paditurës në revizionin e ushtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta hedh poshtë revizionin dhe të vërteton Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.523/2006.
14. Më 10 korrik 2008, Gjykata Supreme e Kosovës pranon revizionin e të paditurës, me aktvendim Rev.nr.99/2007, të datës 10 korrik 2008, prish aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.523/2006, të datës 19 janar 2007, prish aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.881/2005, të datës 26 tetor 2006 dhe lëndën e kthen në shkallë të parë për rigjykim.
15. Më 24 shtator 2010, Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykim C.nr.697/2008, të datës 24 shtator 2010, për të tretën herë vendos në favor të *ankuesit*, duke e obliguar të paditurën Raiffeisen Bank që ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës dhe t'i kompensojë të ardhurat personale.
16. Më 10 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktvendim AC.nr.666/2010, të datës 10 shtator 2012, aprovon ankesën e të paditurës, prish aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.697/2008, të datës 24 shtator 2010 dhe lëndën për të tretën herë e kthehen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
17. Më 20 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prizren me Aktgjykim C.nr.899/2012, të datës 24 korrik 2015, aprovon kërkesëpadinë e *ankuesit*. E paditura kundër Aktgjykimit të lartë cekur ushtron ankesë në Gjykatën e Apelit, por deri më tani nuk dihet nëse gjykata ka ndërmarrë ndonjë veprim për të vendosur lidhur me ankesën.
18. Më 7 qershor 2017, *ankuesi* paraqiti ankesë në IAP lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore të Gjykatës për shqyrtimin e lëndës AC.nr.3451/2015.
19. Më 4 gusht 2017 dhe më 20 shtator 2017, Avokati i Popullit, iu drejtua me shkresë kryetarit të Gjykatës së Apelit, për të kërkuar informata lidhur me veprimet që gjykata i ka ndërmarrë dhe planifikon t'i ndërmarrë për shqyrtimin e çështjes së parashtruar nga *ankuesi*, por në asnjërin letër nuk ka marrë përgjigje.
20. Më 10 maj 2018, përfaqësuesi i IAP, është informuar nga zyrtari për informim në Gjykatën e Apelit, se çështja e z. Biqaku, akoma nuk ka përfunduar.
21. Më 21 maj 2018, *ankuesi* ka informuar zyrën e Avokatit të Popullit se ende nuk ka pranuar asnjë vendim nga gjykata lidhur me rastin.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

22. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 thekson: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, [...]*.”
23. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: “*Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedure para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike*”
24. Po ashtu, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, në nenin 54 të Kushtetutës, përcakton: “*Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”.
25. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.¹ Paragrafi 1 i nenit 6 i KEDNJ garanton që: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor*”.
26. Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7 par. 2 përcakton: “*Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedure e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor*”.
27. Ndërsa, neni 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat nr. 03/L-199, përcakton: “*Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve*”.
28. Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, në nenin 10, par. 1 të këtij ligji përcakton: “*Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji*”.
29. Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 190, paragrafi 3, parasheh se: “*Gjykata e shkallës së dytë do ta caktoj shqyrtimin e drejtpërdrejtë të çështjes edhe po qe se aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dy herë dhe kur në seancën e kolegjit vlerëson se aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë*”.
30. Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 475, parasheh se:

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22

“Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.”

Analiza ligjore

31. Avokati i Popullit tërheqë vëmendjen tek praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së/
32. Në raste të shumta, GJEDNJ ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
33. Avokati i Popullit përkujton që, praktika e GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih, aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).
34. Avokati i Popullit vëren se GJEDNJ ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).
35. Sipas praktikës së GJEDNJ-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga data 9 dhjetor 2003, kur paditësi ka paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Prizren. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit
36. Njëkohësisht, mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e të së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë:
“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”
37. Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).

38. Neni 13 i KEDNJ pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë, për një individ, që e bënë të mundur që ai/ajo, të gëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrijë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih, Aktgjykimi *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimimi efektiv, pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi që rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
39. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e "një ankese të kontestueshme" sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih, p.sh. Aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih, p.sh. Aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).
40. Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit përkujton se "mjetet efektive" në kuptim të nenit 13 do të duhej që të kishin qenë në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih, Aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*).
41. Në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.

Konstatimet e Avokatit të Populli

42. Avokati i Popullit rikujton se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore e që në rastin konkret, është 9 dhjetor 2003, dhe konstaton se zvarritja e tillë pa vendim përfundimtar shkelë:
- Të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të KEDNJ.*
- Të drejtën për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 13 të KEDNJ.*
- Të drejtën për mbrojtje gjyqësore të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*
43. Duke u bazuar nga të cekurat më lartë, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, "[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore", dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit "Avokati i Popullit mund të

jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës:

REKOMANDON

Gjykatën e Apelit

- ***Që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtim dhe vendosje të lëndës AC. nr. 3451/2015***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit